L I G J
Nr.9054, datë 24.4.2003

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FRANCEZE PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË PËR TATIMET MBI TË ARDHURAT E MBI KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet "Konventa ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze për shmangien e taksimit të dyfishtë për tatimet mbi të ardhurat e mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3810, datë 8.5.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

KONVENTË
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FRANCEZE PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Franceze:
duke dëshiruar të përfundojnë një Konventë për eliminimin e tatimeve të dyfishta lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për shmangien e evazionit fiskal,
kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1
Fushëveprimi i Konventës

Kjo Konventë do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose e të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2
Tatimet që mbulon Konventa

1. Kjo Konventë do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të zbatuara në emër të një Shteti Kontraktues ose nga autoritetet e tij lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.
2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale, mbi kapitalin në total ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat totale të pagave të paguara prej punëdhënësve, si edhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit (rritjen e vlerës së

kapitalit).

3. Tatimet ekzistuese, ndaj të cilave do të zbatohet Konventa, janë në veçanti:

a) Në rastin e Francës:

i) tatimi mbi të ardhurat ("l'impot sur le revenu);

ii) tatimi mbi kompanitë ("l'impot sur les societes");

iii) tatimi mbi pagat ("la taxe sur les salaires");

iv) tatimi mbi pasurinë ("l'impot de solidarite sur la fortune");

v) "kontributet sociale të përgjithshme" ("contributions sociales generalisees");

vi)"kontributet për rimbursimin e detyrimeve sociale" ("contributions pour le remboursement de la dette sociale");

vii) kontributi mbi tatimin e korporatave ("la contribution sur l'impot sur les societes);

përfshirë çdo tatim të mbajtur në burim, parapagim (precompte) ose pagesë në avancë lidhur me tatimet e sipërpërmendura;

(në vijim do t'u referohemi si "tatimet franceze").

b) Në rastin e Shqipërisë:

i) tatimi mbi të ardhurat (përfshirë tatimin mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale);

ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

iii) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t'u referohemi si "tatimet shqiptare").

4. Konventa do të zbatohet gjithashtu për çdo tatim të njëllojtë ose tepër të ngjashëm, të cilët do të vendosen pas datës së nënshkrimit të Konventës si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim thelbësor që do të bëhet në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

Neni 3

Përcaktime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) Termat "Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Francën ose Shqipërinë siç e kërkon përmbajtja.

b) Termi "Franca" nënkupton territoret europiane dhe ato përtej detit (overseas departments) të Republikës Franceze përfshirë ujërat territoriale dhe çdo zonë jashtë ujërave territoriale brenda të cilave, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Republika Franceze ka të drejta sovrane me qëllim zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore të tabanit detar, nëntokës dhe ujërave detare.

c) Termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe, kur përdoret në sensin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, ujërat territoriale dhe çdo zonë tej ujërave territoriale brenda të cilave, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Republika e Shqipërisë ka të drejta sovrane për zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore të tabanit detar dhe nëntokës së saj.

d) Termi "person" përfshin një individ, një shoqëri (kompani) dhe çdo grup tjetër personash.

e) Termi "shoqëri (kompani)" nënkupton çdo organ korporativ ose çdo ent që trajtohet si organ korporativ për qëllime tatimore.

f) Termat "sipërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues.

g) Termi "trafik ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije ose avion që operohet nga një sipërmarrje që ka vendin e saj të drejtimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija ose avioni vepron vetëm midis vendeve të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues.

h) Termi "autoritet kompetent" nënkupton:

i) në rastin e Francës, ministrin e ngarkuar me buxhetin ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij;

ii) në rastin e Shqipërisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

i) Termi "nënshtetas" nënkupton:

i) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzon statusin si e tillë në përputhje me ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues.

2. Përsa i përket zbatimit të Konventës në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term që nuk është përcaktuar këtu, do të ketë kuptimin që i është dhënë atij termi sipas legjislacionit të atij shteti lidhur me tatimet, ndaj të cilave zbatohet Konventa. Kuptimi i një termi sipas ligjeve tatimore në fuqi në atë shtet do të ketë prioritet mbi kuptimin që i jepet atij termi në ligje të tjera të atij shteti.

Neni 4
Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj Konvente, termi "rezident i një Shteti Kontraktues" nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme, dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo autoritet lokal atje. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat që i nënshtrohen tatimit në atë shtet vetëm për të ardhurat e realizuara në atë shtet ose kapitali i vendosur aty.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) Ai do të konsiderohet rezident i shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident i shtetit, me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike).

b) Në qoftë se shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave jetike, nuk mund të përcaktohet ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin shtet, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues në të cilin ai qëndron rregullisht.

c) Në qoftë se ai qëndron rregullisht në të dy shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident i Shtetit Kontraktues, nënshtetas i të cilit ai është.

d) Në qoftë se ai është nënshtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin çështjen me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1 një person juridik është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident i shtetit në të cilin ka vendin e drejtimit efektiv.

Neni 5
Seli (përfaqësi) e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Konvente termi "seli (përfaqësi) e përhershme" nënkupton një vend fiks biznesi, nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht aktiviteti i një sipërmarrjeje.

2. Termi "seli e përhershme" përfshin në veçanti:

a) një vend drejtimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte;

f) një minierë, një pus nafte ose gazi, një gurore ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. a) Një shesh ndërtimi, një konstruksion, një projektinstalimi ose montimi përbën një seli të përhershme vetëm nëse zgjat më tepër se 12 muaj.

b) Megjithatë, një shesh ndërtimi, një konstruksion, një projektinstalimi ose montimi që fillon gjatë periudhës prej dhjetë vjetësh që pason menjëherë pas datës nga e cila Konventa fillon zbatimin, përbën një seli të përhershme vetëm nëse zgjat për më tepër se nëntë muaj. Pas kësaj periudhe dhjetëvjeçare do të zbatohen vetëm dispozitat e nënparagrafit (a).

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni termi "seli e përhershme" nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e pajisjeve ose objekteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje (transportimi) të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi apo shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga

një sipërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm me qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni për sipërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim ushtrimi, për sipërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët (a) deri (e), me kusht që i tërë aktiviteti i vendit fiks të biznesit që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur, ndaj të cilit aplikohet paragrafi 6, vepron në emër të një sipërmarrjeje dhe ka, dhe zakonisht ushtron në atë Shtet Kontraktues një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, ajo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në atë shtet për çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4 të cilat, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk e bëjnë këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme në bazë të dispozitave të atij paragrafi.

6. Një sipërmarrje nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në një Shtet Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznes në atë shtet tjetër nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti komisioner të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë në kuadrin e zakonshëm të aktivitetit të tyre. Megjithatë, kur aktivitetet e një agjenti të tillë kryhen tërësisht ose thuajse tërësisht për llogari të asaj sipërmarrjeje, ai nuk do të konsiderohet si agjent me status të pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi.

7. Fakti që një shoqëri, që është rezidente e një Shteti Kontraktues, kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri, që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues ose që ushtron biznes në atë shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në forma të tjera), nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për ta konsideruar njërën shoqëri seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6
Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) mund të tatohen në Shtetin Kontraktues ku ndodhen këto pasuri të paluajtshme.

2. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "pasuri e paluajtshme" do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufruktin e pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose variabël për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar, vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet dhe avionët nuk do të konsiderohen pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

5. Kur aksionet ose të drejta të tjera në një shoqëri, trust apo institucion të krahasueshëm konsistojnë në pronësinë mbi pasuri të paluajtshme të ndodhura në një Shtet Kontraktues dhe të mbajtura nga ajo shoqëri, trust apo institucion i krahasueshëm, të ardhurat e realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira apo përdorimi në çdo formë tjetër i asaj të drejte pronësie mund të tatohen në atë shtet, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 14.

Neni 7
Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur sipërmarrja ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Në qoftë se sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e

sipërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues selisë së përhershme do t'i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte sikur ajo të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme nën kushte të njëjta ose të ngjashme, tërësisht e pavarur nga sipërmarrja, seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, do të lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive të kryera për këtë qëllim, si në shtetin ku ndodhet selia e përhershme ashtu edhe gjetkë.

4. Kur në një Shtet Kontraktues përcaktimi i fitimeve që do t'i atribuohen një selie të përhershme zakonisht bëhet në bazë të ndarjes së fitimeve totale të sipërmarrjes midis pjesëve të veçanta të saj, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues për përcaktimin e fitimeve që do të tatohen në bazë të një metode të tillë; megjithatë, metoda e ndarjes së fitimeve duhet të jetë e tillë që rezultati të jetë në përputhje me parimet që dalin nga ky nen.

5. Asnjë fitim nuk do t'i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se ajo blen mallra për sipërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm të këtij neni, fitimet që i atribuohen një selie të përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë çdo vit përderisa nuk ka arsye të drejta dhe të mjaftueshme për të vepruar ndryshe.

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj Konvente, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8
Transporti detar dhe ajror

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve ose avionëve në trafikun ndërkombëtar do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

2. Nëse vendi i drejtimit efektiv të një sipërmarrjeje detare është në bordin e një anijeje, atëherë ai do të konsiderohet i vendosur në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i qëndrimit të zakonshëm të anijes ose, nëse nuk ka një port të tillë, në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është përdoruesi i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një marrëveshje, një biznes të përbashkët ose në një agjenci ndërkombëtare transporti.

Neni 9
Sipërmarrje të lidhura

1. Kur:

a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin ose kapitalin e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë diktuar midis dy sipërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra sipërmarrje, por që për shkak të lidhjeve të veçanta të përmendura në fillim nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të tatohet normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një sipërmarrjeje të atij shteti - dhe i taton ato normalisht - fitime për të cilat një sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues i është nënshtruar tatimit në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të realizoheshin nga sipërmarrja e shtetit të përmendur në fillim, nëse kushtet e vendosura midis sipërmarrjeve do të ishin ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë Shteti tjetër Kontraktues do të bëjë rregullimin e duhur në shumën e tatimit që ka ngarkuar mbi ato fitime, nëse ky shtet tjetër e

konsideron këtë rregullim të justifikuar. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla do të mbahen parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese në rast nevoje do të konsultohen me njëri-tjetrin.

Neni 10
Dividentët

1. Dividentët e paguar nga një shoqëri, që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto dividentë mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është shoqëria paguese e dividentëve dhe në përputhje me ligjet e atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividentëve është një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividentëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri që zotëron direkt ose indirekt të paktën 25 për qind të kapitalit të kompanisë paguese të dividentëve;

b) 15 për qind të shumës bruto të dividentëve në të gjitha rastet e tjera.

Dispozitat e këtij paragrafi nuk do të kenë efekt mbi tatimin e shoqërisë lidhur me fitimet nga të cilat janë paguar dividentët.

3. Një rezident i Shqipërisë që merr dividentë të paguar nga një shoqëri që është rezidente e Francës mund të përfitojë rimbursim të parapagimit (precompte) deri në kufirin e paguar efektivisht nga shoqëria për dividentë të tillë. Shuma bruto e parapagimit (precompte) të rimbursuar do të konsiderohet si divident për qëllime të Konventës. Dispozitat e paragrafit 2 do të zbatohen ndaj kësaj shume bruto.

4. Termi "dividentë" nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji, që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrjen në fitime, si edhe të ardhurat e trajtuara si shpërndarje nga ligjet tatimore të Shtetit Kontraktues, rezidente e të cilit është shoqëria që bën shpërndarjen e dividentëve. Eshtë e kuptueshme se termi "dividentë" nuk përfshin të ardhurat e përmendura në nenin 16.

5. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 nuk do të zbatohen, nëse pronari përfitues i dividentëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është shoqëria paguese e dividentëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe zotërimi lidhur me të cilin janë paguar dividentët është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në një rast të tillë do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

6. Kur një shoqëri, që është rezidente e një Shteti Kontraktues, realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky shtet tjetër mund të mos zbatojë tatim mbi dividentët e paguar nga shoqëria, përveç kur këta dividentë, i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër ose kur zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividentët, është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose bazë fikse të vendosur në këtë shtet tjetër; subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe sikur dividentët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë shtet tjetër.

7. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 6 të nenit 25, kur një shoqëri që është rezidente e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, fitimet e asaj selie të përhershme, pasi të jetë paguar tatim fitimi, do t'i nënshtrohen, në përputhje me ligjet e këtij shteti tjetër, një tatimi, niveli i të cilit nuk i kalon 5 për qind.

8. Dispozitat e Konventës do të zbatohen vetëm nëse pronari përfitues i dividentëve, rezident i një Shteti Kontraktues, tregon, kur një gjë e tillë i kërkohet nga administrata tatimore e Shtetit tjetër Kontraktues, që zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividentët, nuk ka si qëllim kryesor apo si një nga qëllimet kryesore, qëllimin e përfitimit prej këtij neni.

Neni 11
Interesat

1. Interesat që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të tatohen edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por, kur marrësi është pronari përfitues i interesave, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesat e përmendura në paragrafin 1 do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është përfituesi, nëse ai person është pronari përfitues i interesave dhe plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) ky person është një nga Shtetet Kontraktuese ose një nga autoritetet e tij lokale, ose një institucion publik i tyre, përfshirë bankën qendrore të atij shteti, ose këto interesa paguhen prej njërit prej Shteteve Kontraktuese ose prej një autoriteti lokal apo një institucioni publik të tyre;

b) këto interesa paguhen lidhur me një hua ose kredi të garantuar ose të siguruar apo mbështetur nga një Shtet Kontraktues, apo një person që vepron në emër të një Shteti Kontraktues.

4. Termi "interesa" nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë të emetuara nga shteti, të ardhurat nga obligacionet, përfshirë fitimet, shpërblimet prej këtyre letrave me vlerë dhe obligacioneve. Gjobat e ngarkuara për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen si interesa për qëllime të këtij neni. Termi "interesa" nuk do të përfshijë lloje të të ardhurave që konsiderohen si dividentë nën dispozitat e nenit 10.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin krijohen (lindin) interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në këtë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe kërkesa e huasë, lidhur me të cilën paguhet interesi, është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose 14, si të paraqitet rasti.

6. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të marrëdhënieve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në huanë për të cilën paguhen, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

8. Dispozitat e Konventës nuk do të zbatohen nëse kërkesa e borxhit, lidhur me të cilën paguhen interesat, është krijuar ose vendosur me qëllim sigurimin e përfitimeve nga ky nen.

Neni 12

Honoraret

1. a) Honoraret (të ardhurat nga e drejta e autorit) që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë Shtet tjetër.

b) Megjithatë, këto honorare mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, kur marrësi është pronari përfitues i honorareve, por tatimi i ngarkuar nuk duhet të kalojë 5 për qind të shumës bruto të honorarit.

2. Në funksion të këtij neni, termi "honorare" nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte të autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, plan, proces ose formulë sekrete apo për informacione lidhur me eksperiencën industriale, tregtare ose shkencore.

3. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të

pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhen honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

4. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

5. Kur, për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë shuma e shpërblimit që kalon shpërblimin normal do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

6. Dispozitat e Konventës nuk do të zbatohen nëse e drejta ose pronësia që krijon honoraret është krijuar apo vendosur kryesisht për qëllim të sigurimit të përfitimeve nga ky nen.

Neni 13
Fitimet nga kapitali

1. a) Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme mund të tatohen në Shtetin Kontraktues ku ndodhen këto pasuri të paluajtshme.

b) Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve ose i të drejtave të tjera në një shoqëri, një trust apo institucion të krahasueshëm, asetet ose pronësia e të cilave konsiston për më tepër se 50 për qind të vlerës së tyre ose realizojnë më tepër se 50 për qind të vlerës së tyre, direkt ose indirekt nëpërmjet ndërthurjes së një apo më shumë shoqërive të tjera, trusteve apo institucioneve të krahasueshme, nga pasuri të paluajtshme të vendosura në një shtet Kontraktues apo i të drejtave të lidhura me të tilla pasuri të paluajtshme mund të tatohen në atë shtet. Për qëllime të kësaj dispozite, pasuritë e paluajtshme që i përkasin veprimtarisë industriale, komerciale apo bujqësore të shoqërive të tilla ose kryerjes së shërbimeve të tyre personale nuk do të merren në konsideratë.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme, që bëjnë pjesë në pasuritë e biznesit të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuritë e luajtshme, që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i kësaj baze fikse, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive që bëjnë pjesë në pasurinë biznesore të një sipërmarrjeje dhe që përbëhen nga anije ose avionë që operohen nga kjo sipërmarrje në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve ose avionëve do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët 1, 2 dhe 3 do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

Neni 14
Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues, lidhur me shërbimet profesionale ose shërbime të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç në rrethanat që vijojnë, ku këto të ardhura mund të tatohen gjithashtu në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse në Shtetin tjetër Kontraktues që rregullisht i shërben atij për kryerjen e aktiviteteve të tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohet asaj baze fikse mund të tatohet në atë shtet tjetër;

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose kalojnë 183 ditë në çdo periudhë të vazhdueshme 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin përkatës kalendarik; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave të realizuara nga aktivitetet e tij të ushtruara në atë shtet tjetër mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Termi "shërbime profesionale" përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose të mësimdhënies, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe llogaritarëve.

Neni 15
Shërbimet personale të varura

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16, 18, 19 dhe 21, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi i tij do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë, atëherë këto të ardhura mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Përjashtuar dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues, lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur në fillim nëse:

a) përfituesi është prezent në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që në total nuk i kalojnë 183 ditë në çdo periudhë të vazhdueshme 12-mujore që fillon ose përfundon në vitin kalendarik përkatës;

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër;

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mëparshme të këtij neni, shpërblimet e realizuara lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anije ose avioni që operohet në trafikun ndërkombëtar mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

Neni 16
Shpërblimet e drejtorëve

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i bordit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie, që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

Neni 17
Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist teatri, kinematografie, radiotelevizioni, muzikant, apo një sportist, nga aktivitetet e tij personale si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë realizohen jo direkt nga vetë artisti ose sportisti, por nga një person tjetër, pavarësisht nëse është rezident i një Shteti Kontraktues ose jo, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit ose sportistit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist ose sportist nga aktivitetet e tij personale si të tilla të ushtruara në Shtetin tjetër Kontraktues do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur në fillim nëse ato aktivitete në shtetin tjetër mbështeten kryesisht nga fonde publike të shtetit të përmendur në fillim ose të autoriteteve të tij lokale, ose të institucioneve të tyre publike.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, kur të ardhurat e realizuara lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues, që është një artist ose sportist, në

kapacitetin e tij si i tillë në shtetin tjetër Kontraktues realizohen jo nga vetë artisti ose sportisti, por nga një person tjetër, qoftë rezident i një Shteti Kontraktues ose jo, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur në fillim, nëse ai person tjetër është mbështetur kryesisht nga fonde publike të atij shteti të përmendur në fillim ose autoriteteve lokale, apo institucioneve të tyre publike.

Neni 18
Pensionet

Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme që i paguhen për punësimin në të kaluarën një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 19
Shërbimet qeveritare

1. a) Pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues ose nga një autoritet lokal atje, ose nga një institucion publik i tyre, një individi, lidhur me shërbimet e kryera atij shteti, autoriteti ose institucioni publik, do të tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto paga dhe shpërblime të ngjashme do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë kryer në atë shtet dhe individi është rezident dhe nënshtetas i atij shteti, pa qenë në të njëjtën kohë nënshtetas i shtetit të përmendur në fillim.

2. a) Çdo pension i paguar nga, apo prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues ose autoritet lokal atje, ose nga një prej institucioneve të tyre publike, një individi, lidhur me shërbimet e kryera ndaj atij shteti, autoriteti apo institucioneve publike, do të tatohen vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto pensione do të tatohen vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individi është rezident dhe nënshtetas i atij shteti, pa qenë në të njëjtën kohë nënshtetas i shtetit të përmendur në fillim.

3. Dispozitat e neneve 15, 16 dhe 18 do të zbatohen ndaj pagave dhe shpërblimeve të tjera të ngjashme dhe ndaj pensioneve, lidhur me shërbimet e kryera në lidhje me një biznes të ushtruar nga një Shtet Kontraktues ose një autoritet lokal atje, ose nga një institucion i tyre publik.

Neni 20
Studentët

1. Pagesat që një student ose specializant, i cili është ose ishte menjëherë para vajtjes në një Shtet Kontraktues rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që ndodhet në shtetin e përmendur në fillim vetëm për qëllim arsimimi ose trajnimi, përfiton për qëllim të mbajtjes së tij, arsimimit ose specializimit, nuk do të tatohen në atë shtet, me kusht që të tilla pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

2. Përsa i përket dhurimeve, bursave dhe shpërblimeve nga punësimi që nuk mbulohen nga paragrafi 1, që një student ose specializant i përshkruar në paragrafin 1 do të marrë si shtesë gjatë arsimimit ose specializimit, do të gëzojnë të njëjtat përjashtime apo reduktime tatimore ashtu si studentët ose specializantët që janë rezidentë të shtetit pritës.

Neni 21
Pedagogët dhe kërkuesit shkencorë

1. Një individ që është rezident i një Shteti Kontraktues menjëherë përpara vajtjes në Shtetin tjetër Kontraktues dhe që shkon në atë shtet me qëllimin kryesor të mësimdhënies ose përfshirjes në aktivitete kërkimore-shkencore në një universitet, kolegj ose institucion tjetër për mësimdhënie ose kërkim shkencor do të tatohet vetëm në shtetin e përmendur në fillim mbi të ardhurat e tij nga shërbimet personale nga kjo mësimdhënie ose kërkim shkencor për një periudhë që nuk i kalon dy vjet nga data e ardhjes së tij në shtetin tjetër.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave nga kërkimet shkencore, nëse këto kërkime ndërmerren jo për interesin publik, por në radhë të parë për përfitime private të një personi ose personave të veçantë.

Neni 22
Të ardhura të tjera

1. a) Lloje të ardhurash të përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, që nuk lidhen me nenet e mësipërme të kësaj Konvente do të tatohen vetëm në atë shtet, nëse ky rezident i nënshtrohet tatimit për këto lloj të ardhurash në atë shtet. Nëse kjo kërkesë nuk plotësohet, ato zëra të ardhurash do të mbeten të tatueshme në Shtetin tjetër Kontraktues dhe në përputhje me ligjet e atij shteti tjetër.

b) Kushtet e taksimit të përcaktuara në nënparagrafin (a) nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i atyre të ardhurave është një Shtet Kontraktues ose një autoritet lokal atje.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave, që nuk janë të ardhura nga pasuria e paluajtshme të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty dhe e drejta ose pasuria lidhur me të cilën paguhet shpërblimi është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

Neni 23
Kapitali

1. a) Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme që i referohen nenit 6 mund të tatohen në Shtetin Kontraktues ku ndodhen këto pasuri të paluajtshme.

b) Kapitali i përfaqësuar nga aksione apo të drejta të tjera në një kompani, një trust ose një institucion të krahasueshëm, asetet ose pronësia e të cilit konsiston për më tepër se 50 për qind të vlerës së tyre ose realizojnë më tepër se 50 për qind të vlerës së tyre, direkt ose indirekt nëpërmjet ndërthurjes së një ose më shumë shoqërive, trusteve ose institucioneve të krahasueshme nga pasuri të paluajtshme, të ndodhura në një Shtet Kontraktues apo të drejtat e lidhura me këto pasuri të paluajtshme, mund të tatohen në atë shtet. Për qëllime të kësaj dispozite, pasuri të paluajtshme, që i përkasin veprimtarisë industriale, komerciale ose bujqësore të shoqërive të tilla ose kryerjes së shërbimeve personale të pavarura nuk do të merren në konsideratë.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anije dhe avionë që operojnë në trafikun ndërkombëtar dhe nga pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve dhe avionëve do të tatohet vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet.

Neni 24
Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1) Në rastin e Francës tatimi i dyfishtë do të eliminohet në mënyrën që vijon:

a) Pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër e kësaj Konvente, të ardhurat që mund të tatohen apo do të tatohen në Shqipëri në përputhje me dispozitat e Konventës do të merren në konsideratë për llogaritjen e tatimit francez, kur këto të ardhura nuk përjashtohen nga tatim fitimi në përputhje me ligjin e brendshëm tatimor francez. Në këtë rast, tatimi shqiptar nuk do të jetë i reduktueshëm nga këto të ardhura, por rezidenti i Francës, pa cenuar kushtet dhe kufijtë e dhëna në nënparagrafët (i) dhe (ii),

do të jetë subjekt i një kreditimi tatimor përkundrejt tatimit francez. Ky kreditim tatimor do të jetë i barabartë:

i) në rastin e të ardhurave të ndryshme nga ato të përmendura në nënparagrafin (ii), me shumën e tatimit francez që i atribuohet atyre të ardhurave me kusht që ai rezident i Francës i është nënshtruar tatimit shqiptar për ato të ardhura;

ii) në rastin e të ardhurave subjekt i tatimit korporativ, referuar nenit 7 dhe paragrafit 2 të nenit 13 dhe të ardhurat, referuar neneve 10, 11 dhe 12, paragrafit 1 të nenit 13, paragrafit 3 të nenit 15, nenit 16 dhe paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 17, me shumën e tatimit të paguar në Shqipëri në përputhje me dispozitat e atyre neneve; megjithatë, ky kreditim tatimor nuk do të kalojë shumën e tatimit francez që i atribuohet këtyre të ardhurave.

b) Një rezident i Francës që zotëron kapitale që mund të tatohen në Shqipëri në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1, 2 ose 3 të nenit 23 do të jenë gjithashtu të tatueshme në Francë për këto kapitale. Tatimi francez do të llogaritet duke lejuar një kreditim tatimor të barabartë me shumën e tatimit të paguar në Shqipëri për këto kapitale. Megjithatë, një kreditim i tillë tatimor nuk do ta kalojë shumën e tatimit francez që u atribuohet këtyre kapitaleve.

c) (i) Është e kuptueshme që termi "shuma e tatimit francez që u atribuohet këtyre të ardhurave" i përdorur në nënparagrafin (a) nënkupton:

- kur tatimi mbi këto të ardhura llogaritet duke aplikuar një tarifë proporcionale, shuma e të ardhurës neto në fjalë e shumëzuar me tarifën që aktualisht aplikohet ndaj asaj të ardhure;

- kur tatimi mbi këto të ardhura llogaritet duke aplikuar një tarifë progresive, shuma e të ardhurës neto në fjalë e shumëzuar me tarifën që rezulton nga raporti i tatimit aktualisht të pagueshëm mbi të ardhurat neto në total të tatueshme në përputhje me ligjin francez me shumën e atyre të ardhurave neto në total.

Ky interpretim do të zbatohet për analogji për termin "shuma e tatimit francez që i atribuohet këtyre kapitaleve" siç është përdorur në nënparagrafin (b).

ii) Është e kuptueshme se termi "shuma e tatimit e paguar në Shqipëri" e përdorur në nënparagrafët (a) dhe (b) nënkupton shumën e tatimit shqiptar efektivisht dhe definitivisht të ngarkuar në lidhje me llojet përkatëse të të ardhurave ose kapitalit, në përputhje me dispozitat e Konventës, nga një rezident i Francës që tatohet për ato lloje të ardhurash apo kapitalesh në përputhje me ligjin francez.

2) Në rastin e Shqipërisë, tatimi i dyfishtë do të shmanget në mënyrën që vijon:

a) Kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatohen në Francë, Shqipëria do të lejojë:

i) një reduktim nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Francë;

ii) një reduktim nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Francë.

Megjithatë, në asnjë rast, ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat ose mbi kapitalin të llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në Francë.

b) Kur në përputhje me dispozitat e Konventës të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i Shqipërisë përjashtohen nga tatimi në Shqipëri, në llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat ose kapitalin e mbetur të këtij rezidenti, Shqipëria merr në konsideratë të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 25

Mosdiskriminimi

1. a) Nënshtetasit e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë në Shtetin tjetër Kontraktues, subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë sesa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen nënshtetasit e këtij shteti tjetër në rrethana të njëjta, në veçanti lidhur me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht nga dispozitat e nenit 1, do të zbatohet gjithashtu ndaj personave që nuk janë rezidentë të njërit apo asnjërit prej Shteteve Kontraktuese.

b) Për qëllime të nënparagrafit (i), është e kuptueshme se një individ, një person juridik,

ortakëri ose shoqëri që është rezident i një Shteti Kontraktues nuk vendoset në të njëjtat rrethana si një individ, person juridik, ortakëri ose shoqëri që nuk është rezident i atij shteti; kjo do të zbatohet sido që të jetë përkufizimi i shtetësisë, edhe nëse personat juridikë, ortakëritë ose shoqëritë konsiderohen të jenë nënshtetas të Shtetit Kontraktues, rezidentë të të cilit ata janë.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, ose i një baze fikse që një rezident i një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë shtet tjetër, sesa tatimi i vjelur ndaj sipërmarrjeve ose rezidentëve të këtij shteti tjetër që ushtrojnë aktivitete të njëjta. Kjo dispozitë nuk do të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'u garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues lehtësime personale ose reduktime për qëllime tatimore që u garanton rezidentëve të shtetit të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familjare që ata kanë.

3. Përjashtuar rastet kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 7 të nenit 11 ose paragrafit 5 të nenit 12, interesat, honoraret dhe shpërblime të tjera të paguara nga një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj sipërmarrjeje, do të jenë të reduktueshme nën të njëjtat kushte njëlloj sikur ato t'i paguheshin një rezidenti të shtetit të përmendur në fillim. Në mënyrë të ngjashme, çdo borxh i një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër Kontraktues, për efekt të përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj sipërmarrjeje, do të jetë i reduktueshëm nën të njëjtat kushte njëlloj sikur sipërmarrja të kishte kontraktuar me një rezident të shtetit të përmendur në fillim.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilit është totalisht ose pjesërisht i zotëruar ose kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkese të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen sipërmarrjet tjera të ngjashme të shtetit të përmendur në fillim.

5. a) Kontributet, që një individ, i cili kryen shërbime personale të varura (i punësuar) në një Shtet Kontraktues, i paguan një skemë pensioni të krijuar dhe të njohur për qëllime tatimore në Shtetin tjetër Kontraktues, do të reduktohen në shtetin e përmendur në fillim, në përcaktimin e të ardhurave të tatueshme të individit dhe do të trajtohen në atë shtet, në të njëjtën mënyrë dhe do të jenë subjekt i të njëjtave kushte dhe kufizime si kontributet e paguara në një skemë pensionesh që është e njohur për qëllime tatimore në shtetin e përmendur në fillim, me kusht që ajo skemë pensionesh pranohet nga autoriteti kompetent i atij shteti si skema e pensioneve që i korrespondon përgjithësisht asaj të njohur si të tillë për qëllime tatimore nga ai shtet.

b) Për qëllime të nënparagrafit (a):

i) termi "një skemë pensioni" nënkupton një rregullim (marrëveshje) në të cilën merr pjesë një individ në mënyrë që të sigurojë përfitime pensioni të pagueshme për shërbime personale të varura të referuara në nënparagrafin (a);

ii) një skemë pensioni është e njohur për qëllime tatimore në një shtet, nëse kontributet për atë skemë janë shpenzim i lejuar (i reduktueshëm) për efekt tatimi në atë shtet.

6. Përjashtimet dhe avantazhe të tjera të dhëna nga ligjet tatimore të një Shteti Kontraktues në përfitim të atij shteti ose autoriteteve të tij lokale apo institucioneve të tyre publike, të cilat kryejnë një aktivitet jobiznesor do të aplikohen nën të njëjtat kushte respektivisht ndaj Shtetit tjetër Kontraktues ose autoriteteve të tij lokale apo institucioneve të tyre publike që ushtrojnë një aktivitet të njëjtë apo të ngjashëm. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 7, dispozitat e këtij paragrafi nuk do të zbatohen për taksat ose pagesat si rezultat i shërbimeve të kryera.

7. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji dhe përshkrimi.

8. Nëse të tjera traktate bilaterale, marrëveshje apo konventa midis Shteteve Kontraktuese, përveç kësaj Konvente, përfshijnë një klauzolë të mosdiskriminimit apo klauzolën e kombit më të favorizuar, është e kuptueshme se klauzola të tilla nuk do të zbatohen për çështje tatimore.

Neni 26
Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit apo e të dy Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht

nga mënyrat e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre shteteve, ai mund t'ua paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues, rezident i të cilit ai është ose, nëse çështja e tij ka të bëjë me paragrafin 1 të nenit 25, ai mund t'ia paraqesë atë Shtetit Kontraktues, nënshtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë lidhur me veprimin që ka rezultuar në tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit, që nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht nga limitet kohoret të përcaktuara nga ligjet e brendshme të Shteteve Kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi ose dyshim që lind nga interpretimi ose zbatimi i Konventës. Në veçanti, ato mund të konsultohen së bashku, të përpiqen të bien dakord për të njëjtën ndarje (alokim) të të ardhurave midis sipërmarrjeve të lidhura të përmendura në nenin 9. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk sigurohet nga Konventa.

4. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të komunikojnë me njëri- tjetrin direkt, edhe nëpërmjet një komisioni të përbashkët të përbërë prej tyre dhe përfaqësuesve të tyre, me qëllim arritjen e mirëkuptimit në kuptimin e paragrafëve të mësipërm të këtij neni.

Neni 27
Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet që mbulon Konventa, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me Konventën. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij shteti dhe do t'u serviret vetëm personave ose autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen ose mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore ose lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Konventa. Këto persona ose autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime. Ato mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 nuk do të interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktues detyrimin:

a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve dhe praktikës normale administrative të atij Shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japë informacione që mund të nxirrnin një sekret biznesi, tregtar, industrial ose profesional ose informacione, komunikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

3. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji dhe përshkrimi të vjelura prej Shteteve Kontraktuese.

Neni 28
Asistenca në mbledhjen e tatimeve

1. Me kërkesë të autoritetit kompetent të një Shteti Kontraktues (në vijim do t’i referohemi si "Shteti kërkues"), autoriteti kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues (në vijim do ti referohemi si "Shteti i kërkuar"), në bazë të dispozitave të paragrafëve 7 dhe 9, do të marrë masat e nevojshme për të trajtuar kërkesat (pretendimet) tatimore të shtetit të përmendur në fillim njëlloj si ato të ishin të vetat. Është e kuptueshme se termi "kërkesë tatimore" nënkupton çdo shumë tatimi, si edhe interesat përkatëse, dënimet administrative dhe gjobat dhe koston e nevojshme për t’u mbledhur, që janë detyrim akoma i papaguar.

2. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen vetëm për kërkesat tatimore, të cilat përbëjnë subjekt të një instrumenti dhe praktike në përputhje me procedurat e vjeljes së detyruar në Shtetin kërkues dhe, përderisa të mos jetë rënë dakord ndryshe midis autoriteteve kompetente të Shteteve Kontraktuese, të cilat nuk e kanë kundërshtuar.

3. Detyrimi për të dhënë asistencë në trajtimin e kërkesave për mbledhje tatimi lidhur me një person të sëmurë ose trashëgiminë e tij, kufizohet në vlerën e trashëgimisë apo pronësisë së përfituar prej secilit përfitues në trashëgimi, në përputhje me faktin nëse kërkesa (tatimi) do të mblidhet nga trashëgimia apo përfituesit e saj atje.

4. Me kërkesë të autoritetit kompetent të Shtetit kërkues, autoriteti kompetent i Shtetit të kërkuar, me synim vjeljen e shumës së tatimit, do të marrë masat për konservimin (bllokimin apo ruajtjen e mundësisë së mbledhjes) edhe nëse kërkesa është kundërshtuar apo akoma nuk është bërë subjekt i zbatimit të dispozitave që lejojnë zbatimin e masave shtrënguese (mbledhjen me forcë).

5. Kërkesa për asistencë administrative do të shoqërohet me:

a) një deklaratë që specifikon natyrën e kërkesës tatimore dhe, në rast mbledhje, faktin që kushtet e dhëna në paragrafin 2 janë plotësuar;

b) një kopjo zyrtare e dispozitës që lejon përdorimin e masave shtrënguese në Shtetin kërkues;

c) çdo dokument tjetër të kërkuar për mbledhjen apo masat e konservimit (bllokimit).

6. Instrumenti (dispozita) që lejon zbatimin e masave shtrënguese në Shtetin kërkues, kur është e zbatueshme dhe konform dispozitave në fuqi në Shtetin e kërkuar, do të pranohet, njihet, plotësohet ose zëvendësohet sa më shpejt që të jetë e mundur pas datës së pranimit të kërkesës për asistencë, nga një instrument (dispozitë, urdhër) që lejon zbatimin e masave shtrënguese në shtetin e fundit (pranues).

7. Pikëpyetjet lidhur me çdo periudhë përtej së cilës një kërkesë tatimore nuk mund zbatohet, do të administrohen nga ligjet e Shtetit kërkues. Kërkesa për asistencë duhet të japë detaje të sakta lidhur me atë periudhë.

8. Veprimet e mbledhjes (administrimit) të kryera nga Shteti i kërkuar në zbatim të një kërkese për asistencë, të cilat, në përputhje me ligjet e brendshme të atij shteti, do të kishin efektin e spostimit apo ndërprerjes së periudhës së përmendur në paragrafin 7, do ta kenë gjithashtu këtë efekt në bazë të ligjeve të Shtetit kërkues. Shteti i kërkuar do të informojë Shtetin kërkues rreth këtyre veprimeve.

9. Në çdo rast, Shteti i kërkuar nuk është i detyruar të përmbushë një kërkesë për asistencë që është lëshuar pas një periudhe prej 15 vjetësh nga data e instrumentit origjinal që lejon zbatimin e masës shtrënguese për vjeljen e detyrimit.

10. Shteti i kërkuar mund të lejojë spostimin e pagesës apo pagesën me këste, nëse ligjet e tij apo praktikat administrative ia lejojnë një gjë të tillë në rrethana të ngjashme, por më parë duhet të informojë Shtetin kërkues.

11. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht nga dispozitat e nenit 2, do të zbatohen ndaj tatimeve të çdo lloji dhe përshkrimi të vjelura nga Shtetet Kontraktuese.

Neni 29

Funksionarët diplomatikë dhe konsullorë

1. Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë dhe të anëtarëve të misioneve të përhershme të organizmave ndërkombëtare që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozita të marrëveshjeve të veçanta.

2. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 4, një individ që është anëtar i një misioni diplomatik, konsullor apo misioni të përhershëm të një Shteti Kontraktues, i cili ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues ose në një shtet të tretë, do të konsiderohet për qëllime të Konventës të jetë rezident i Shtetit dërgues, nëse ai i nënshtrohet në Shtetin dërgues të njëjtave detyrime tatimore për të ardhurat e tij në total dhe kapitalin që zotëron, njëlloj si rezidentët e atij shteti.

3. Konventa nuk do të zbatohet ndaj organizatave ndërkombëtare, organeve apo zyrtarëve të tyre dhe personave që janë anëtarë të një misioni diplomatik, zyre konsullore apo misioni të përhershëm të një shteti të tretë, që janë prezent në një Shtet Kontraktues dhe nuk i nënshtrohen në njërin Shtet Kontraktues të njëjtave detyrime tatimore për të ardhurat e tyre në total apo kapitalin që zotërojnë si rezidentët e atij shteti.

Neni 30
Hyrja në fuqi

1. Secili prej Shteteve Kontraktuese do të njoftojë tjetrin për kompletimin e procedurave të kërkuara lidhur me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente. Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë që pason ditën kur është marrë më i vonshmi prej njoftimeve të sipërpërmendura.

2. Dispozitat e Konventës do të kenë efekt:

a) lidhur me tatimet mbi të ardhurat e mbajtura në burim, për shumat e tatueshme pas vitit kalendarik në të cilin Konventa hyn në fuqi;

b) lidhur me tatimet mbi të ardhurat që nuk janë mbajtur në burim, për të ardhurat që i takojnë, sipas rastit, çdo viti kalendarik ose periudhe kontabël që fillon pas vitit kalendarik në të cilin Konventa hyn në fuqi;

c) lidhur me tatime të tjera, për tatimin apo fenomenin e tatueshëm, i cili ndodh pas vitit kalendarik në të cilin Konventa hyn në fuqi.

Neni 31
Përfundimi

1. Kjo Konventë do të mbetet në fuqi pafundësisht. Megjithatë, pas një periudhe prej pesë vitesh kalendarike nga data në të cilën Konventa hyn në fuqi, secili Shtet Kontraktues mund të përfundojë Konventën, duke dhënë njoftimin me shkrim të përfundimit nëpërmjet kanalave diplomatike, të paktën 6 muaj përpara përfundimit të çdo viti kalendarik.

2. Në rast të tillë Konventa do të pushojë së pasuri efekt:

a) lidhur me tatimet mbi të ardhurat e mbajtura në burim, për shumat e tatueshme pas vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit;

b) lidhur me tatimet mbi të ardhurat që nuk janë mbajtur në burim, për të ardhurat që i takojnë, sipas rastit, çdo viti kalendarik ose periudhe kontabël që fillon pas vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit;

c) lidhur me tatime të tjera, për tatimin apo fenomenin e tatueshëm, i cili ndodh pas vitit kalendarik në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

Në praninë dhe të autorizuar në mënyrën e duhur, nënshkruesit kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Tiranë, më 24 dhjetor 2002 në dy kopje, në gjuhët frënge dhe shqipe, të dy tekstet janë ligjërisht të barasvlefshme.

PROTOKOLL

Në të njëjtën kohë me firmosjen e Konventës ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe për parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, nënshkruesit kanë rënë dakord që dispozitat që vijojnë do të përbëjnë një pjesë integrale të Konventës.

1. Lidhur me nënparagrafin (a) të paragrafit 3 të nenit 2, tatimi mbi pagat rregullohet nga dispozitat e Konventës së aplikueshme, sipas rastit, ndaj fitimeve nga biznesi apo të ardhurave nga shërbimet personale të pavarura.

2. Lidhur me nenin 4, është e kuptueshme që termi "rezident i një Shteti Kontraktues" do të përfshijë, kur ai shtet është Franca, çdo ortakëri apo grup personash që ka vendin e drejtimit efektiv në Francë dhe të gjithë aksionerët, ortakët apo anëtarë të tjerë, të cilët personalisht i nënshtrohen tatimit atje lidhur me pjesën e tyre të fitimit në përputhje me ligjin e brendshëm francez.

3. Lidhur me paragrafin 4 (a) dhe (b) të nenit 5 është e kuptueshme se "shpërndarja" e kryer nga një gjendje mallrash të vendosura në një Shtet Kontraktues do të përbëjë një seli të përhershme atje nëse operacione të tjera të ndryshme nga magazinimi, ekspozimi, transporti apo operacione të tjera përgatitore apo ndihmëse kryen në atë shtet nga të tilla gjendje mallrash apo nga ato ambiente.

4. Është e kuptueshme se termi "pasuri e paluajtshme", siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit

6, përfshin opsionet (letra me vlerë të përdorura në bursa), vendimet apo garanci të shitjeve dhe të drejta të tjera të ngjashme lidhur me pasuri të tilla.

5. Lidhur me nenin 7:

a) kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues shet mallra ose ushtron biznese në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, fitimet e asaj selie të përhershme nuk do të përcaktohen në bazë të shumës totale të marrë nga sipërmarrja, por vetëm në bazë të shpërblimit që i atribuohet aktivitetit aktual të selisë së përhershme për shitje apo biznese të tilla;

b) në raste kontratash, në veçanti për mbikëqyrje, furnizim, instalim apo ndërtim të ambienteve apo pajisjeve industriale, tregtare apo shkencore, apo të punimeve publike, kur sipërmarrja ka një seli të përhershme, fitimet e kësaj selie të përhershme nuk do të përcaktohen në bazë të shumës totale të kontratës, por vetëm në bazë të asaj pjese të kontratës që efektivisht kryhet nga selia e përhershme në Shtetin Kontraktues ku ajo ndodhet. Fitimet që i takojnë pjesës së kontratës që zbatohet në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes do të tatohen vetëm në atë shtet.

6. Lidhur me nenin 12, pagesat e marra si shpërblim për shërbimet teknike, përfshirë studimet apo mbikëqyrjet e natyrës shkencore, gjeologjike apo teknike, apo për kontrata inxhinieringu përfshirë manualet teknike e ligjore të lidhura me to, ose për shërbime konsultative apo mbikëqyrjeje, nuk do të konsiderohen si pagesa të marra si shpërblim për informacione të lidhura me eksperiencën industriale, tregtare apo shkencore.

7. Dispozitat e nenit 16 do të zbatohen ndaj të ardhurave që i referohen nenit 62 të kodit tatimor francez (code general des impots) që realizohen nga një individ që është rezident i Shqipërisë si një partner (ortak) apo menaxher në një kompani, e cila është rezidente e Francës dhe subjekt i tatim fitimit atje.

8. Dispozitat e Konventës në asnjë rast nuk do ta pengojnë Francën nga zbatimi i dispozitave të nenit 212 të kodit të saj tatimor (code general des impots) ose çdo dispozitë esencialisht të ngjashme që mund të ndryshojë apo zëvendësojë dispozitat e atij neni.

9. Secili prej Shteteve Kontraktuese do të ruajë të drejtën e tatimit, në përputhje me ligjet e tij të brendshme, të çdo të ardhure të rezidentëve të vet, taksimi i të cilave i atribuohet Shtetit tjetër Kontraktues, por që nuk është përfshirë në bazën tatimore në atë shtet, në rastet kur një përjashtim i tillë i dyfishtë rezulton nga një përkufizim (kualifikim) i ndryshëm i të ardhurave në fjalë.

10. a) Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të vendosin bashkërisht ose veçmas për mënyrën e zbatimit të Konventës.

b) Në veçanti, në mënyrë që të realizohen në një Shtet Kontraktues përfitimet e dhëna nga nenet 10, 11 dhe 12, rezidentët e Shtetit tjetër Kontraktues, përderisa nuk është vendosur ndryshe nga autoritetet kompetente, duhet t'i paraqesin një dokument të vërtetimit të rezidencës ku të jepet në veçanti natyra dhe shuma apo vlera e të ardhurave apo kapitalit në fjalë, duke përfshirë edhe vërtetimin e administratës tatimore të atij shteti tjetër.

Bërë në Tiranë, më 24 dhjetor 2002 në dy kopje, në gjuhët frënge dhe shqipe, të dy tekstet janë ligjërisht të barasvlefshme.